

*Pranimet në ciklin e dytë të studimeve “Master professional” dhe “Master i shkencave”/”Master i arteve”*

Viti Akademik 2022 – 2023 / Kreu IV/4		Afatet e përfundimit dhe datat e realizimit
1.	Kreu IV/4, pika 1 Aplikimet në programet e studimit të ciklit të dytë me kohë të plotë, për të gjitha kategoritë e kandidatëve, për çdo vit akademik të bëhen pranë sekretarive mësimore të njëjësive kryesore, në datat e përcaktuara, për çdo vit akademik.	Deri më 18.10.2022
2.	Kreu IV/4, pika 2 Brenda afateve, IAL-të publike dhe jopublike, afishojnë listat e aplikantëve fitues në vende të dukshme, në mjediset e njëjësive kryesore përkatëse, si dhe në faqet elektronike zyrtare (web) të IAL-së, të ndarë sipas programeve të studimit përkatës, të renditur sipas rendit zbritës të pikëve të grumbulluara nga aplikantët, në përputhje me kuotat e pranimeve, të miratuara.	03.11.2022
3.	Kreu IV/4, pika 4 Regjistrimi i kandidatëve në programet e studimit ku janë shpallur fitues të zhvillohet pranë sekretarive mësimore përkatëse të IAL-ve publike dhe jopublike, në datat e përcaktuara.	17.11.2022
4.	Kreu IV/4, pika 5 IAL-ja shpall në vende të dukshme dhe publikon në faqen e saj elektronike zyrtare (web), listën emërore të kandidatëve të regjistruar brenda datave përkatëse të përcaktuara.	19.11.2022
5.	Kreu IV/4, pika 8, shkronja “b” Kanë të drejtë të aplikojnë për programet e ciklit të dytë, kandidatët që: janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të parë, të akredituar. Në rast pranimi kandidati është i detyruar të kryejë njësimin e diplomës pranë QSHA-së brenda muajit të përcaktuar.	Dhjetor 2022
6.	Kreu IV/4, pika 16 IAL-të brenda datës së përcaktuar, dërgojnë pranë QSHA-së, listën e studentëve të regjistruar, në formë shkresore dhe elektronike në format Excel me qëllim pajisjen me numër matrikullimi, sipas programit të studimit dhe tipologjisë së kandidatit. IAL-të nuk duhet të dërgojnë në QSHA të dhënat e asnjë kandidati pas kësaj date. Për të gjithë emrat kandidatë të dërguar pas kësaj date ose që nuk plotësojnë kriteret e parashikuara në legjislacionin në fuqi, nuk do të procedohet me dhënien e numrave të matrikullimit dhe QSHA-ja duhet të kërkojë nga IAL-ja, duke njoftuar edhe kandidatin, çregjistrimin e tyre dhe konfirmimin me shkresë zyrtare brenda një afati 10 ditor për kryerjen e procesit të çregjistrimit të kandidatit nga IAL.	21.12.2022